



# Barometri Kosovar i Sigurisë

Edicioni i katërt

Dhjetor, 2014



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

**Botues:** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Projekti u mbështet nga:** National Endowment for Democracy

## EKIPI I BKS

**Mentor Vrajolli**, Koordinator i programit

**Donika Emni dhe Skender Perteshi**, Koordinatorë të projektit

**Mentor Vrajolli dhe Sofije Kryeziu**, Interpretues të të dhënave

**Tringa Naka**, Sigurimi i cilësisë

**Redaktimi i brendshëm:** Florian Qehaja

**Redaktimi profesional:** Shpend Kursani

**Redaktor:** Thomas Desai

© Të gjitha të drejtat e këtij botimi janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe prona intelektuale mbrohen me *ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta*.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë dhe përmes asnjë mjeti elektronik, mekanik apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga botuesi. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i të gjitha materialeve të botuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa pëlqimin me shkrim të QKSS. Ju lutem kontaktoni në: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org) or +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport vijnë prej informacioneve të mbledhura nga të anketuarit, dhe në të paraqiten perceptimet se si i shohin ata institucionet e përfshira në studim. Raporti nuk ka të bëjë me ndonjë farë vlerësimi përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve, të cilat kanë qenë subjekt i këtij studimi. Megjithatë, ai mund t'ju shërbejë si një udhëzues për trajtimin e mangësive të mundshme të cilat paraqiten në raport, por edhe si tregues se sa efektiv e kanë komunikimin e vet me publikun. Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve, dhe nuk i paraqesin medoemos pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.

Mendimet e shprehura në këtë raport nuk i paraqesin medoemos pikëpamjet as të National Endowment for Democracy (NED).

<b>Çfarë është Barometri Kosovar i Sigurisë? .....</b>	<b>4</b>
Kujt i drejtohem me këtë raport? .....	4
Ndikimi .....	4
Metodologjia.....	4
<b>KAPITULLI I.....</b>	<b>6</b>
<b>Institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë.....</b>	<b>6</b>
Perceptimi për institucionet e sigurisë .....	7
Perceptimi publik për sistemin e drejtësisë .....	12
Perceptimi publik për institucionet fetare, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat .....	13
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>15</b>
<b>Kërcënimet për sigurinë e Kosovës .....</b>	<b>15</b>
Kërcënimet kryesore ndaj sigurisë sipas qytetarëve të Kosovës.....	15
Kërcënimet e përgjithshme të brendshme për sigurinë kombëtare të Kosovës.....	16
Kërcënimet e jashtme për sigurinë e shtetit.....	18
Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia .....	21

---

## ÇFARË ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i QKSS, i cili, si botim i përvitshëm i veçantë, ka për qëllim që të bëjë matjen e trendëve të opinionit publik në lidhje me performancën e institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë, si dhe perceptimin e sfidave kryesore të sigurisë me të cilat përballet Kosova, duke i përfshirë këtu kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë, si dhe të politikës së jashtme të Kosovës. Për shkak të fokusit specifik që ka në çështjet e sigurisë dhe të drejtësisë roli i BKS si instrument i rëndësishëm matës vazhdon të rritet. Ajo që është më e rëndësishmja, KSB paraqet një prej nismave të para dhe të vetme në Kosovë që është hartuar, realizuar, dhe publikuar prej një organizatë profesionale e pavarur vendore siç është QKSS. Andaj si i tillë, KSB nuk përballet me ndonjë kufizim të aspektit politik në komunikimin e rezultateve dhe mesazheve të analizave të bëra përmes këtij raporti. Në fund, BKS-ja është unike edhe për qasjen metodologjike të cilën e zbaton, respektivisht të gërshetimit unik të metodave kuantitative dhe kualitative me qëllim të ofrimit të rezultateve sa më reale sa i përket perceptimeve të publikut karshi çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë.

---

### Kujt i drejtohem me këtë raport?

BKS i QKSS-së i drejtohet palëve të ndryshme të cilat janë të interesuara t'i përcjellin trendet e opinionit publik në Kosovë në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë. Më konkretisht, raporti i drejtohet hartuesve të politikave si në Kosovë ashtu edhe në Ballkanin Perëndimor; organeve ndërkom-bëtare në Kosovë si dhe selive të tyre; organizatave vendore dhe ndërkombëtare të shoqërisë civile; institucioneve akademike dhe mediave.

---

### Ndikimi

Ndikimi i BKS-së pritet që të shumëfishohet në një periudhë afatmesme duke pasur parasysh këta indikator: (a) rritja e vazhdueshme e besueshmërisë ndaj QKSS-së si një organizatë profesionale e pavarur dhe pa prapavijë politike, (b) përvoja e gjatë e QKSS-së në zbatimin e metodave të duhura shkencore në hulumtimet e veta, (c) nevoja për fuqizimin e rolit të ekspertizës vendore; si dhe (b) resurset profesionale që QKSS disponon.

---

### Metodologjia

Edicioni i katërt i BKS-s ofron një përmbledhje të shkurtër të perceptimeve të publikut sa i përket institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë; rreziqeve, kërcënimeve dhe qëndrueshmërisë ekonomike të qytetarëve; si dhe kërcënimeve të brendshme e të jashtme. Në krahasim me versionet paraprake, ky edicion i BKS-s i përfshinë përgjigjet e të anketuarve edhe në disa pyetje shtesë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të perceptimeve sa i përket politikës së jashtme të Kosovës dhe dialogut me Serbinë.

Përgjigjet e parashtruara me anë të pyetësorëve të BKS-s u mbledhën përmes intervistave, të zhvilluara në prani fizike të drejtëpërdrejtë të personave të përfshirë, e të cilat u realizuan në gjithë territorin e Kosovës. Me përjashtim të dy pyetjeve, të gjitha pyetjet e tjera kanë qenë të formatit të mbyllur, dhe shumica e tyre ishin të bazuara në modelin e Likert-it prej pesë shkallësh. Verifikimi i mostrës, pilotimi dhe intervistat u zhvilluan prej ekipit të QKSS-s, i përbërë prej më shumë se 30 hulumtuesve në terren. Mostra gjithëpërfshirëse në nivel vendi, prej të cilës u realizua hulumtimi, përbëhej prej 1,101 ekonomive familjare, ku janë targetuar qytetar të Kosovës të moshës mbi 18 vjeç. Ndarja etnike e të anketuarve në këtë edicion të BKS-s ishte: 87.92 për qind shqiptarë të Kosovës, 9.08 për qind serbë të Kosovës, dhe 3 për qind pjesëtar të komuniteteve tjera etnike (boshnjakë 1.0 për qind, turq 1.0 për qind, dhe RAE 1.0 për qind).

Korniza e mostrës u bazua në kodin zonal të telefonisë fikse, në bazë të së cilit është realizuar ndarja e territorit të Kosovës në 7 rajonet si në vijim: Prishtinë, Mitrovicë, Prizren, Ferizaj, Gjiilan, Pejë dhe Gjakovë. Faza e parë e grupimit gjeografik u bazua të Cenzusit të realizuar në vitin 2011 në Kosovë; faza e dytë përfshinte grupimin e mostrave sipas komunave me një mostër të stratifikuar rurale/urbane e cila u realizuar duke marr për bazë numrin e ekonomive familjare; dhe faze e fundit u përcoll me një metodë të mostrës së rastit, ku u shfrytëzua 'metoda e ditëlindjes' më të përafërt. Përdorimi i mostrës së rastit i mundëson secilit banor në Kosovë ta ketë probabilitet të barabartë sa i përket përzgjedhjes për qenë i intervistuar potencial në këtë anketë. Mostra e shfrytëzuar për këtë studim mundëson që rezultatet e sondazhit t'i përfaqësojnë trendet e përgjithshme të qëndrimeve dhe të perceptimeve të tërë popullatës madhore të Kosovës. Si rrjedhojë, margjina e gabimit është 3 për qind, ndërsa intervali besimi është 95 për qind.

Fillimisht, para fillimi të punës në terren janë realizuar disa intervista pilotuese me qëllim që testimit të fizibilitetit të pyetësorit. Ekipi hulumtues kishte raportuar se intervistat pilotuese kishin rezultuar si të suksesshëm, dhe se nuk kishte pasur ndonjë problem me pyetjet të cilat iu parashtruan të intervistuarve të fazës pilotuese, duke hapur rrugën fillimit të punës në terren. Të gjitha intervistat janë kryer gjatë muajit tetor të vitit 2014. Procesimi dhe analizimi i të dhënave është kryer përmes softuerit SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport vijnë prej informacioneve të mbledhura nga të anketuarit, dhe se ato paraqesin vetëm perceptimin se si i sheh popullata institucionet e përfshira në këtë studim. Raporti nuk paraqet në asnjë mënyrë ndonjë vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve të cilat kanë qenë subjekt i këtij studimi. Qëllimi i QKSS-s, me këtë botim, është vetëm interpretimi i perceptimeve apo, me fjalë të tjera, i asaj se "çfarë thonë" qytetarët e Kosovës lidhur me fushat e mbuluara në pyetësor. Ekipi i QKSS-s nuk mban ndonjë përgjegjësi për rezultatet që dalin prej të dhënave, posaçërisht nëse ato e nxisin reagimin e ndonjërit nga subjektet e përfshira në studim. Ekipi është i gatshëm ta bëjë transparent tërë procesin, duke përfshirë edhe metodologjinë e shfrytëzuar, nëse ndonjë prej subjekteve të studimit është i interesuar për një gjë të tillë.

# KAPITULLI I

## INSTITUCIONET E SIGURISË DHE TË DREJTËSISË


Matja e perceptimit publik, në lidhje me institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë, përbën një pjesë të rëndësishme të programit të *Barometrit Kosovar të Sigurisë* (BKS). Ngjashëm me atë që është prezantuar në edicionet e mëparshme të BKS-s, edhe në këtë edicion përfshihen një varg institucionesh si: Policia e Kosovës (PK), Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), doganat, zjarrfikësit, qeveria, KFOR-i, EULEX-i, prokuroria, dhe gjykatat.

Për të elaboruar perceptimet e publikut karshi institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë janë përdorur tre tregues kryesor:

- Niveli i besimit të qytetarëve për secilin prej këtyre institucioneve;
- Shpeshësia e kontaktit midis qytetarëve dhe secilit prej këtyre institucioneve;
- Perceptimi i shkallës së korrupsionit për secilin prej këtyre institucioneve.


Në vija të gjëra, rezultatet e sondazhit tregojnë se Forca e Sigurisë e Kosovës, KFOR-i dhe zjarrfikësit janë tre institucionet më të besueshme në sy të publikut. Më shumë se 60 për qind e qytetarëve janë përgjigjur se ‘u besojnë’ ose ‘u besojnë shumë’ këtyre tre institucioneve. Përveç kësaj, rreth 15 për qind e qytetarëve u përgjigjën se ‘u besojnë deri diku’ këtyre institucioneve. Këto të gjetura janë relativisht të ngjashme me gjetjet në edicionet e mëparshme të BKS-s, me dallimin e vetëm se zjarrfikësit tani janë në krye të listës së këtyre institucioneve, duke ia marrë pozitën udhëheqëse FSK-s, e cila e mbante këtë pozitë në edicionet e mëparshme.

**FIGURA 1: Tre institucionet më të besueshme**



Në anën tjetër, tre institucionet më pak të besueshme, sipas të anketuarve, duket të jenë: qeveria, prokuroria, dhe gjykatat. Në fakt, më shumë se 63 për qind e të anketuarve theksuan se nuk i besojnë qeverisë. Arsyet të cilat qëndrojnë prapa këtij niveli kaq të ulët të besimit për qeverinë lidhen edhe me bllokadën politike, e cila nisi në qershor të vitit 2014 dhe vazhdoi edhe gjatë periudhës kur u realizua ky hulumtim. Të gjeturat tregojnë po ashtu se vazhdon të jetë i ulët besimi i publikut karshi sistemit të drejtësisë. Ky perceptim bazohet pjesërisht në përvojën e drejtpërdrejtë të qytetarëve të Kosovës me këto institucione, përkatësisht me vetë gjykatat. Për më tepër, siç do ta shihni më pashtë tre institucionet më pak të besueshme rezultuan të jenë edhe tre institucionet më të korruptuara (siç perceptohen prej të anketuarve) sipas perceptimeve të qytetarëve, ku më shumë se 60 për qind e të anketuarve theksuan se këto institucione janë 'të korruptuara' ose 'shumë të korruptuara'.



**FIGURA 2: Tre institucionet më pak të besueshme**



Kryesisht janë dy faktorë që ndikojnë në ndertimin e perceptimeve të qytetarëve sa i përket institucione: kontakti i drejtpërdrejtë, dhe raportimi i mediave. Sa i përket kontakteve të drejtpërdrejta, janë Policia e Kosovës, doganat, kompanitë private të sigurimit ato që ju prijnë listës së institucioneve sa i përket ndërveprimit më të shpeshtë me të anketuarit. Në gjë e tillë nënkupton se perceptimi i të anketuarve lidhur me këto institucione është krijuar kryesisht prej ndërveprimit të drejtpërdrejtë me to. Ndërsa, institucionet me të cilat të anketuarit deklaruan se kishin ndërvepruar më së paku janë: Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), EULEX, dhe prokurorinë.

## Perceptimi për institucionet e sigurisë

Ky edicion i BKS-s është marrë me analizimin e perceptimit publik për gjashtë institucione vendore të sigurisë (qeverinë, Policinë e Kosovës, Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, dhe doganat), si dhe për dy institucione ndërkombëtare të sigurisë (KFOR dhe EULEX). Në përgjithësi, të gjeturat në këtë edicion, sa i përket këtyre institucioneve të sigurisë, janë të ngjashme me të gjeturat e realizuara në edicionet e mëparshme të BKS-s.

**FIGURA 3: Tre institucionet e kontaktuar më së shpeshti****FIGURA 4: Tre institucionet e kontaktuar më së paku.**

Institucionet më të besueshme të sigurisë vazhdojnë të jenë: zjarrfikësit (me 66.8 për qind), FSK-ja (me 65.8 për qind), dhe PK (me 43.5 për qind). Në të vërtetë, kur kemi të bëjmë me FSK-në, vetëm 12.9 për qind e të anketuarve kanë shfaqur një shkallë mosbesimi karshi këtij institucioni; megjithatë, 76.7 për qind e të anketuarve nuk kanë pohuar të kenë pasur ndonjë kontakt të drejtpërdrejtë me këtë institucion (që është një përqindje mjaft e lartë). Besimi i të anketuarve për zjarrfikësit është i lartë; por, si me FSK-në, shumica e të anketuarve, apo 77.0 për qind, nuk kanë pohuar se kanë pasur ndonjë kontakt të drejtpërdrejtë me ta. Si rezultat, duket se njerëzit i kanë krijuar perceptimet e tyre lidhur me këto dy institucione të sigurisë kryesisht në bazë të faktorëve të tjerë, e jo përmes ndërveprimit të drejtpërdrejtë. Në anën tjetër, edhe pse duket se kemi një shkallë mesatare të besimit ndaj Policisë së Kosovës, sondazhi tregon se 59.8 për qind e të anketuarve kanë pasur ndërveprim të shpeshtë me këtë institucion. Andaj, ndërveprimi i drejtpërdrejtë duket se është një prej faktorëve kryesor që i ka shtyrë të anketuarit ta krijojnë mendimin e vet lidhur me këtë institucion.



FIGURA 5: Tre institucionet më të besueshme të sigurisë






FIGURA 6: Shpeshësia e kontakteve të qytetarëve me institucionet më të besueshme të sigurisë




Në anën tjetër, të gjeturat tregojnë se tre institucionet që kanë të bëjnë me sferën e sigurisë, e të cilave u besohet më së paku janë: qeveria (me 63 për qind), e pasuar nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (me 34.4 për qind) dhe doganat (me 30.2 për qind). Shkalla e lartë e mosbesimit për qeverinë e dëshmon krizën e legjitimitetit të qeverisë, e ndikuar, mes tjerash, edhe nga ngërçi disamujor, ku përfshihet edhe periudha realizimit të këtij studim. Sa i përket shkallës së lartë të mosbesimit ndaj AKI, një gjë e tillë mund të jetë shkaktuar si rezultat i raportimeve mediatike të vazhdueshme brenda skandaleve brenda kësaj Agjencie, ku dyshohej për përfshirjen e zyrtarë të lartë të saj. Megjithatë, një faktor tjetër vendimtar për nxitje të perceptimeve negative nga ana e të anketuarve drejt AKI-së është edhe mungesa e informacionit lidhur me punën e saj, gjë që pjesërisht të jetë edhe rezultat i natyrës së veçantë të funksioneve që ka duke ndikuar në "barrikadimin" e saj dhe të qenit institucion pothuajse krejtësisht jo transparent. Në fakt, gati 18 për qind e të anketuarve deklaruan se nuk kishin njohuri për AKI-n, dhe 94 për qind e të anketuarve u shprehën se nuk e kanë kontaktuar asnjëherë këtë institucion. Në fund, sondazhi e tregon edhe një shkallë mjaft të madhe të mosbesimit ndaj shërbimit doganor, ku 30.2 për qind e të anketuarve janë shprehur se nuk i besojnë këtij institucioni, ndërsa vetëm 35.2 për qind janë deklaruar se i besojnë institucionit në fjalë. Në anën tjetër, sa i përket shpeshësisë së ndërveprimit, 52.2 për qind e të anketuarve janë shprehur se kanë ndërvepruar drejtpërdrejtë me doganat.

**FIGURA 7: Tre institucionet më së paku të besueshme të sigurisë**




**FIGURA 8 : Shpeshhtësia e kontakteve midis qytetarëve dhe institucioneve më së paku të besueshme**




Të anketuarit kanë shfaqur pikëpamje kritike edhe sa i përket perceptimit ndaj nivelit të prezencës së korrupsionit në kuadër të institucioneve vendore të sigurisë. Këtu, më shumë se 73 për qind e të anketuarve u deklaruan se qeveria është e korruptuar, ku 59 për qind e tyre u shprehën se është shumë e korruptuar, dhe vetëm 12 për qind kanë shpreh mendim të kundërt. Sa i përket komunave, 55 për qind e të anketuarve janë shprehur se administrata e komunave përkatëse ku ata jetojnë është e korruptuar, ndërsa vetëm 20 për qind janë shprehur se nuk është e korruptuar. Sa i përket Policisë së Kosovës, perceptimi i qytetarëve për policinë ka qenë i ndarë. Rreth 33.5 për qind e të anketuarve janë deklaruar se PK-ja nuk është e korruptuar, kurse 34 për qind të tjerë pretendojnë se PK-ja është e korruptuar. Po ashtu, edhe mbi 20 për qind të tjerë deklaruan se PK është deri diku e korruptuar, apo kanë refuzuar që të japin një përgjigje. Në ndërkohë, perceptimi i qytetarëve të Kosovës për FSK-në është shumë më pozitiv. Rreth 69 për qind e të anketuarve janë deklaruar se FSK-ja nuk është institucion i korruptuar, ndërsa 20 për qind të tjerë deklaruan se FSK-ja është deri diku e korruptuar, ose kishin refuzuar që të japnin përgjigje. Në anën tjetër, vetëm 7 për qind e të intervistuarve kishin konsideruar këtë institucion si të korruptuar.

**FIGURA 9: Perceptimi i qytetarëve lidhur me korrupsionin**




Kur kemi të bëjmë me institucionet ndërkombëtare brenda sektorit kosovar të sigurisë, të gjeturat tregojnë se besimi për EULEX-in vazhdon të mbetet në një nivel të ulët ku 41.9 për qind e të anketuarve janë shprehur se nuk i besojnë këtij misioni. Shkalla e lartë e mosbesimit lidhet kryesisht me perceptimin e kontributit të kufizuar të këtij misioni karshi mbështetjes së dhënë për institucionet e Kosovës për ta parandaluar dhe për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Në anën tjetër, KFOR-i vazhdon të mbetet ndër institucionet më të besueshme ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, 63.8 për qind e të anketuarve janë deklaruar se i besojnë këtij institucioni, ndërsa vetëm 15.7 për qind e kanë deklaruar të kundërtën. Siç shihet në diagramin më poshtë, të anketuarit janë shprehur se tani kanë kontakte të rralla me këtë mision. Andaj, perceptimet e qytetarëve për KFOR-in, mund të thuhet, se janë kryesisht reflektim i kontributit të mëparshëm të cilin e ka dhënë ky mision. Respekti për rolin që ka luajtur në të kaluarën si duket krijon imunitet ndaj çfarëdo pakënaqësie të mundshme drejt KFOR-it sa i përket punës së këtij misioni gjatë vitet e fundit, posaçërisht në lidhje me rolin e tij në pjesën veriore të Kosovës.

**FIGURA 10: Besimi i qytetarëve për EULEX-in dhe KFOR-in**




**FIGURA 11: Shpeshtësia e kontakteve mes qytetarëve dhe EULEX-it dhe KFOR-it**




### Perceptimi publik për sistemin e drejtësisë

Perceptimi i përgjithshëm ndaj sistemit të drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet zhgënjyes. Në të vërtetë, më shumë se gjysma e të anketuarve, apo, për të qenë më të saktë, 52.6 për qind janë deklaruar se nuk i besojnë as prokurorisë, e as gjykatave (me 50.9 për qind); ndërsa vetëm 21.9 për qind përkatësisht 23.7 për qind, janë deklaruar se nuk u besojnë këtyre institucioneve.

**FIGURA 12: Besimi i qytetarëve për institucionet e gjyqësorit**




**FIGURA 13: Shpeshtësia e kontakteve mes qytetarëve dhe institucioneve të gjyqësorit**



Të anketuarit kanë shprehur pikëpamje të ngjashme edhe kur flitej për korrupsionin në kuadër të institucioneve të drejtësisë. Rreth 50 për qind e të anketuarve u shprehën se prokuroria është e korruptuar, prej të cilëve rreth 37.1 për qind janë shprehur se ky institucion është shumë i korruptuar. Në anën tjetër, më pak se 16 për qind e të anketuarve janë shprehur se i besojnë prokurorisë. Të anketuarit ishin edhe më kritikë ndaj gjykatave - perceptim i krijuar kryesisht në bazë të shpeshtësisë së ndërveprimit me to. Rreth 64 për qind e të anketuarve u shprehën se gjykatat në Kosovë janë të korruptuara, dhe 38.4 për qind deklaruan se ato janë shumë të korruptuara. Ndërsa vetëm 16 për qind u deklaruan se gjykatat në Kosovë nuk janë të korruptuara.

**FIGURA 14: Perceptimet e qytetarëve për korrupsionin në sistemin gjyqësor**



## Perceptimi publik për institucionet fetare, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat


Përveç institucioneve të drejtësisë dhe të sigurisë, në këtë edicion të BKS-s është matur edhe besimi i qytetarëve për disa prej institucioneve mendim-formuese në Kosovë, siç janë: media, organizatat e shoqërisë civile, si dhe institucionet fetare.

Të gjeturat në këtë edicion të BKS tregojnë se institucionet fetare vazhdojnë të jenë në mesin e institucioneve më të besueshme. Më saktësisht, 55.3 për qind e të anketuarve u deklaruan se u besojnë institucioneve të tyre përkatëse fetare. Megjithatë, në krahasim me sondazhet e realizuara në edicionet e mëparshme të BKS-s, kësaj here shifra e përqindjes rezultojnë të jetë më e ulët. Kështu, ndryshe nga edicioni i mëparshëm i BKS-s, ku më shumë se 61.9 për qind e të anketuarve ishin deklaruar se u besojnë institucioneve fetare, të gjeturat në këtë edicion tregojnë se kemi një rënie prej më shumë se 6 për qind sa i përket besueshmërisë ndaj institucioneve fetare. Kjo mund të ketë ardhur për shkak të ngjarjeve dhe aksioneve të fundit policore të ndërmarra ndaj disa figurave fetare, dhe e cila mund të ketë pasur ndikim negativ kur bie fjala për besueshmërinë ndaj institucioneve fetare. Përveç kësaj, 24 për qind e të anketuarve janë deklaruar se nuk u besojnë institucioneve fetare, e që është mjaftë e lartë duke e pasur parasysh mjedisin tradicional tolerant fetar, si dhe pikëpamjet që kanë ekzistuar në të kaluarën në Kosovë. 20 për qind të tjerë të të anketuarve janë shprehur se kanë pikëpamje të balancuara.

Në anën tjetër, perceptimi publik për mediat dhe organizatat e shoqërisë civile vazhdon të ketë kontraste të theksuara. Vetëm rreth 32.4 për qind e të anketuarve janë shprehur se u besojnë organizatave të shoqërisë civile, në anën tjetër rreth 29.5 për qind shprehën të kundërtën, kurse rreth 35 për qind e të anketuarve ishin neutral. Në anën tjetër, përqindja e të anketuarit që u

shprehën se u besojnë mediave është pak më e ulët se e atyre që u shprehën se u besojnë organizatave të shoqërisë civile. Rreth 29 për qind e të anketuarve u shprehën se u besojnë mediave, dhe 40.7 për qind të tjerë ishin të pavendosur, ndërsa gati 30 për qind e të anketuarve u deklaruan se nuk u besojnë mediave.

**FIGURA 15: Besimi i qytetarëve për institucionet mendim-formuese lidhur me sigurinë dhe drejtësinë**



## KAPITULLI II

### KËRCËNIMET PËR SIGURINË E KOSOVËS

Ky seksion merret kryesisht me shqetësimet e qytetarëve lidhur me rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës, si dhe ndaj sigurisë së tyre personale. Duke e pasur parasysh se ky vit është karakterizuar prej një varg ngjarjesh politike, etnike dhe fetare, ky edicion i BKS-s synon ta analizojë se deri në çfarë mase kanë arritur të ndikojnë ngjarjet e tilla në formësimin e perceptimit të përgjithshëm të qytetarëve të Kosovës për sigurinë në Kosovë. Në fillim do të merremi me rreziqet dhe kërcënimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare, të cilat janë identifikuar nga të anketuarit (për të cilën është ofruar një pyetje e hapur në mënyrë që të mund të mblidhet kontributi i tyre). Më pas, do të analizohet shkalla deri në çfarë mase gjendja e tanishme në sektorin e sigurisë, stabiliteti politik dhe situata ekonomike mund të përbëjnë rrezik apo kërcënim potencial për sigurinë kombëtare të Kosovës. Pjesët në vijim ofrojnë të gjetura që lidhen me burimet e rreziqeve të jashtme, të cilat i perceptojnë qytetarët si faktorë potencialë de-stabilizues dhe si kërcënim karshi sigurisë së Kosovës, siç janë intervenimet politike dhe kulturore të shteteve të huaja, terrorizmi ndërkombëtar, përfshirja e qytetarëve të Kosovës në konfliktet në Siri dhe Irak, si dhe qasja e Serbisë ndaj Kosovës. Pjesa e fundit synon ta mat atë se deri në çfarë mase janë të vetëdijshëm qytetarët për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.


Fokusi kryesor në këtë kapitull ka të bëjë me perceptimin publik për çështjet në vijim.

- Perceptimet ndaj kërcënimeve të sigurisë;
- Kërcënimet më të mëdha të brendshme për sigurinë e shtetit
- Kërcënimet më të mëdha të jashtme për sigurinë e shtetit
- Mbrojtja e të dhënave personale.

### Kërcënimet kryesore ndaj sigurisë sipas qytetarëve të Kosovës


Fillimisht, gjatë grumbullimi të perceptimeve në fjalë, të intervistuarve ju është shtruar pyetja e hapur ku ju është kërkuar mendimet i tyre personale sa i përket kërcënimeve, të cilat i konsiderojnë si më të ndijshmet për sigurinë kombëtare të Kosovës. Një gjë e tillë është bërë me qëllim që të mos ndikohet në çfarëdo mënyre në perceptimet e qytetarëve të Kosovës sa i përket kërcënimeve të sigurisë, si dhe më qëllim që të kuptohen prej vetë atyre se cilat janë shqetësimet kryesore që i kanë në lidhje me gjendjen e sigurisë së vendit. Të gjeturat tregojnë se qytetarët kishin pikëpamje të ngjashme sa i përket rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë së Kosovës. Siç është rasti edhe me pyetjet në vijim lidhur me temën e njëjtë, dhe të cilat fokusohen në shkallën e rrezikut, papunësia në Kosovë dhe gjendja e përgjithshme ekonomike shihen si rreziku dhe kërcënim kryesor për sigurinë e Kosovës. Pas shkallës së lartë të papunësisë dhe të gjendjes së përgjithshme ekonomike, si kërcënim/rreziqe të anketuarit e kanë përmendur edhe: qasjen e Serbisë karshi Kosovës, çështjet e korrupsionit, situatën politike, radikalizmin fetar dhe ekstremizmin, si dhe dukuri të tjera negative si kriminaliteti, pasiguria, vjedhja dhe drogat.

**FIGURA 16: Kërcënimet kryesore sipas qytetarëve të Kosovës**



## Kërcënimet e përgjithshme të brendshme për sigurinë kombëtare të Kosovës

**FIGURA 17: Burimet e rreziqeve të brendshme të natyrës politike dhe ekonomike.**



Më pas, të anketuarve ju është kërkuar të vlerësoj se në ç'skallë siguria e Kosovës nga rreziqet e listuara. Pyetja i kishte 4 opsione me mundësi të vlerësimit të saj në 6 shkallën sipas modelit të Likertit. Kërcënimi më i madh për sigurinë kombëtare të Kosovës u konsiderua shkalla e lartë e papunësisë. Mbi 92 për qind e të anketuarve e shohin shkallën e papunësisë si të rrezikshme dhe faktor de-stabilizues për gjendjen e sigurisë (77.4 për qind e konsiderojnë si rezik të lartë, ndërsa 15.5 për qind e konsiderojnë atë si me rezik). Në bazë të këtij rezultati duket se qytetarët e rëndomtë të Kosovës sigurinë e perceptojnë nga një këndvështrimi gjithëpërfshirës, ku pasiguria ekonomike e përbën shqetësimin kryesor. Ndërsa duke e pasur parasysh shkallën e lartë të papunësisë (që




vlerësohet të jetë mbi 30.0 për qind në vitin 2013) një perceptim i tillë nuk paraqet ndonjë befasi.<sup>1</sup> Madje, për të përkufizuar gjithë këtë, vetëm 5.5 për qind e të anketuarve u shprehën se shkalla e papunësisë në Kosovë nuk përbën shqetësim për sigurinë (4.8 për qind e shohin si rrezik të ulët, dhe vetëm 0.7 për qind e konsiderojnë atë si me rrezik shumë të ulët).

Sa i përket perceptimit publik në lidhje me çështjen e korrupsionit, 91 për qind e të anketuarve e konsiderojnë korrupsionin si kërcënim të sigurisë së tyre. Ky perceptim për korrupsionin është në vijë me ndryshimin e perceptimit të kosovarëve, të cilët gradualisht po largohen nga perceptimi tradicional i sigurisë në lidhje me këtë faktor, ashtu siç po e konsiderojnë edhe pasigurinë ekonomike. Vetëm 6.4 për qind u deklaruan se korrupsioni paraqet deri diku kërcënim i sigurisë për ta, ndërsa 2 për qind e të anketuarve u shprehën se korrupsioni paraqet rrezik të ulët kur kemi të bëjmë me sigurinë (1.2 për qind e konsiderojnë atë se përbën rrezik të ulët, dhe 0.8 për qind e konsiderojnë atë se përbën rrezik shumë të ulët për sigurinë). Pjesa tjetër e të anketuarve prej 0.7 për qind nuk kishin ndonjë mendim sa i përket kësaj çështje.

Në anën tjetër, paqëndrueshmëria politike shihet si problem i sigurisë nga rreth 75 për qind e të anketuarve. Prej tyre, 50 për qind besojnë se ekziston një shkallë e lartë e rrezikut për shkak të paqëndrueshmërisë politike në Kosovë, ndërsa 24.9 për qind e konsiderojnë atë si rrezik potencial. Në fakt, perceptimi sa i përket paqëndrueshmërisë politike mund të jetë nxitur nga bllokada e fundit politike, e cila, si rrjedhojë, ka ngjallur shqetësime të theksuara te qytetarët. Pjesa e tjetër prej 17.9 për qind e të anketuarve u deklaruan se paqëndrueshmëria politike përbën deri diku rrezik, ndërsa pjesa e mbetur prej 5.4 për qind duket se nuk kanë ndonjë shqetësim sa i përket kësaj çështje.

Po ashtu, anketa tregon se edhe mungesa e liberalizimit të vizave paraqet një brengë tjetër madhore e cila i shqetëson qytetarët tanë. Kështu, pothuajse 67.2 për qind e të anketuarve e shohin mungesën e vizave si brengë të sigurisë. Prej tyre rreth 45 për qind mungesën e liberalizimit të vizave e shohin si një sfidë serioze për mirëqenien e tyre ndërsa 22.2 për qind ndajnë mendimin të njëjtë, por nuk e konsiderojnë këtë çështje të rrezikueshmërisë së lartë. Pjesa tjetër e të anketuarve e shohin deri diku atë si kërcënim (17.7 për qind) ose u deklaruan se mungesa e liberalizimit të vizave nuk përbën ndonjë kërcënim për ta (12.5 për qind).

**FIGURA 18: Burimet e rreziqeve të brendshme**



<sup>1</sup> The World Bank Group in Kosovo, Country Snapshot, tetor 2014, link: <http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/eca/Kosovo-Snapshot.pdf>, vizituar së fundmi më 8 dhjetor 2014.

Kategoria e dytë përceptimeve të matura në lidhje me kërcënimet dhe rreziqet lidhet më shumë me llojet tradicionale të sfidave dhe kërcënimeve ndaj sigurisë kombëtare dhe individuale. Shumica, ose 62.8 për qind e të anketuarve, e shohin kriminalitetin e organizuar si çështje me rrezikueshmëri të lartë për sigurinë e shtetit. Ndërsa 22.3 për qind e të anketuarve u shprehën se krimi i organizuar përbën rrezik për sigurinë e shtetit vetëm në mënyrë të tërthortë. Kjo nënkupton se shumica dërmuese e të anketuarve e shprehën brengën e tyre sa i përket ndikimit të krimit të organizuar në sigurinë shtetërore të Kosovës. Perceptimet e tilla janë në përputhje me performancën e dobët të institucioneve të shtetit në luftimin e krimit të organizuar – një çështje e cila u theksua edhe nga vet të anketuarit. Në anën tjetër, 11.4 për qind e të anketuarve e shohin krimin e organizuar deri diku si kërcënim potencial, dhe vetëm 2.4 për qind e të anketuarve e shohin krimin e organizuar se përbën rrezik të ulët për sigurinë e shtetit.

Problem tjetër të cilin e përmendën të anketuarit si kërcënim të sigurisë, është edhe radikalizmi fetar. Kjo çështje kishte mbizotëruar diskursin publik sidomos kah mesi i vitit 2014 (dhe ende vazhdon të jetë e pranishme) për shkak të pjesëmarrjes së kosovarëve në konfliktin në Siri dhe Irak. Ndërsa, të pyetur se në çfarë mase përbën radikalizmi fetar kërcënim për sigurinë e shtetit, 48.5 për qind e të anketuarve e vlerësuan ky kërcënim paraqet rrezik të lartë, 18 për qind të tyre e konsideruan të jetë me rrezik dhe 13.4 për qind e tyre e konsideruan se paraqet deri diku rrezik. Në anën tjetër, 7.1 për qind e të anketuarve besonin se rreziku prej radikalizmit fetar është i ulët, ndërsa 9.9 për qind e tyre besonin se përbën rrezik shumë të ulët. Në krahasim me përgjigjet e të anketuarve ndaj kërcënimeve të tjera të brendshme të renditura për ta, kishte një përqindje të madhe të tyre të cilët nuk donin ta jepnin mendimin e tyre për këtë çështje (3.1 për qind).

Edhe problemi i sundimi të ligjit në pjesës veriore të Kosovës paraqet shqetësim të anketuarit. Sipas të anketuarve anketuarve, këtu kryesisht këmi të bëjmë mungesën e lirisë së lëvizjes, prezencën e barrikadave dhe të krimit të organizuar në atë pjesë. Të anketuarit janë të vetëdijshëm për implikimet politike, juridike dhe të sigurisë në pjesën veriore të Kosovës. Si rrjedhojë ata shprehen se janë të shqetësuar për situatën atje, dhe se e kondierojnë atë si kërcënim potencial de-stabilizues. Kështu, rreth 47 për qind e të anketuarve mendojnë se gjendja e sigurisë në pjesën veriore të Kosovës përbën shkallë të lartë të rrezikut për sigurinë e vendit, 26.2 për qind të tjerë e shohin atë si me rrezik; rreth 14.3 për qind e konsiderojnë atë si deri diku rrezik; ndërsa 6.3 për qind e shohin atë të jetë me rrezik të ulët si dhe 4.6 për qind si rrezik shumë të ulët.


Për shumicën e të anketuarve, fatkeqësitë natyrore nuk përbëjnë rrezik kur i krahasojmë me kërcënimet e brendshme të sigurisë të përmendura më herët. Arsyeja prapa kësaj i referohet faktit se Kosova, në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit perëndimor, duket se ka numrin më të ulët të fatkeqësive natyrore. Megjithatë rreziku ekziston, dhe sipas më shumë se një të tretës (35.4 për qind) së të anketuarve, fatkeqësitë natyrore janë çështje problematike. Për 21.3 për qind të të anketuarve, fatkeqësitë natyrore shihen vetëm deri në një far mase rrezik vetëm, ndërsa për 41.3 për qind të tjerë, fatkeqësitë natyrore nuk përbëjnë ndonjë rrezik për sigurinë e shtetit.

## Kërcënimet e jashtme për sigurinë e shtetit

Të anketuarve iu kërkua po ashtu që ta bëjnë vlerësimin e rreziqeve të jashtme të sigurisë. Sipas tyre, kërcënimi më i madh i jashtëm për sigurinë është pjesëmarrja e qytetarëve të Kosovës në konfliktin në Siri dhe Irak. Në aspektin statistikor, 90.6 për qind e të anketuarve e shohin pjesëmarrjen e kosovarëve në konfliktet në Lindjen e Mesme me rrezik të lartë apo rrezik për sigurinë e vendit. Rreziku kryesisht konsiderohet se vjen nga kthimi eventual i këtyre individëve në Kosovë dhe

'gatishmëria e tyre luftuese' për të arritur caqet e tyre politike e ideologjike.<sup>2</sup> Në anën tjetër, 12.7 për qind e të anketuarve e shohin pjesëmarrjen e qytetarëve të Kosovës në konfliktet në Lindjen e Mesme deri diku me rrezik, ndërsa vetëm rreth 10.2 për qind e të anketuarve besojnë se ata nuk përbëjnë kurrfarë rreziku për sigurinë e vendit.

**FIGURA 19: Burimet e rreziqeve të jashtme**




Në anën tjetër, edhe Serbia vazhdon të shihet si kërcënim i jashtë, m i sigurisë. Kështu, rreth 52.2 për qind të të anketuarve e shohin qasjen e Serbisë ndaj Kosovës me rrezik të lartë; 19.9 për qind të tjerë shohin atë si me rrezik; si dhe po ashtu edhe 13.7 për qind besojnë se qasja e Serbisë ndaj Kosovës paraqet deri diku me rrezik. Ndërsa vetëm pjesa e mbetur e të anketuarve, 6 për qind respektivisht 6.7 për qind konsiderojnë se qasja e Serbisë përbën rrezik të ulët ose shumë të ulët për sigurinë e shtetit.

Qasja e Serbisë karshi Kosovës, sipas të anketuarve, është çështja e dytë që paraqet më së shumti kërcënim ndaj sigurisë së shtetit. Në krahasim me edicionet e mëparshme të BKS-s, në këtë edicion kemi një ndryshim të dukshëm të perceptimit të opinionit publik ndaj Serbisë. Ndryshimi më i madh është vërejtur, në veçanti, sa i përket çështjes së armiqësive dhe kërcënimit potencial që mund të vijnë prej Serbisë. Në këtë edicion del se rreth 90 për qind e qytetarëve të Kosovës e shohin Serbinë si vend armiqësor, e që është për 20 për qind më shumë se në edicionet e mëparshme të BKS-s. Në edicionet e mëparshme, të gjitha shifrat sa i përket Serbisë qëndronin diku mes 60 dhe 70 përqindëshit. Këto ndryshime në opinionin publik mund të kenë ardhur si rezultat i dhunës që shpërtheu në ndeshjen e futbollit mes Shqipërisë dhe Serbisë, e cila u zhvillua më 14 tetor 2014 në Beograd, si dhe të ngjarjeve që pasuan menjëherë fill pas saj. Duket se kjo ngjarje kishte ndikim të konsiderueshëm në opinion publik në Kosovë sa i përket Serbisë.

<sup>2</sup> Fokus grupi me hulumtuesit e QKSS në terren, 22 tetor 2014.

Vlenë të theksohet se kur flitet për Serbinë, siç dihet ka dallime të theksuara më ndërmjet opinionëve të komunitetit shqiptar dhe serb në Kosovë. Së këndejmi, 76.4 për qind e shqiptarëve të Kosovës e shohin qasjen e Serbisë ndaj Kosovës si kërcënim i jashtëm, në krahasim me 35 për qind të komunitetit serb të Kosovës. Në anën tjetër, vetëm 18.6 për qind e shqiptarëve të Kosovës besojnë se nuk ka rrezik potencial nga Serbia, në krahasim me 40 për qind të serbëve të Kosovës.

**Figura 20: Qasja e Serbisë ndaj Kosovës sipas etnive**



Ekzistojnë edhe çështje të tjera për të cilat janë të shqetësuar qytetarët e Kosovës, dhe një prej tyre janë sëmundjet vdekjeprurëse, si Ebola dhe mundësia e përhapjes së saj në Kosovë. Më shumë se gjysma e të anketuarve janë shprehur të brengosur kur bëhet fjalë për përhapjen e mundshme të sëmundjeve të tilla vdekjeprurëse, ndërsa 22.6 për qind e të anketuarve pretendojnë se ekziston rreziku potencial për përhapjen e sëmundjeve të tilla si Ebola dhe AIDS në Kosovë. Po kështu, 12.7 për qind e të anketuarve pretendojnë se një rrezik i tillë ekziston deri diku; dhe 8.1 për qind dhe 4.9 për qind të tyre pretendojnë se rreziku është i ulët, përkatësisht shumë i ulët për një përhapje të mundshme të sëmundjeve të tilla.


Terrorizmi ndërkombëtar, problem ky i sigurisë për shumicën e vendeve perëndimore, shihet po ashtu si kërcënim potencial për sigurinë e shtetit. Së këndejmi, 60.5 për qind e të anketuarve pohuan se terrorizmi ndërkombëtar përbën një kërcënim serioz të jashtëm për sigurinë e shtetit, të pasuar me 18.8 për qind të tyre që pohuan se ekziston deri diku ky rrezik. Të anketuarit e tjerë prej 17.4 për qind theksuan se një rrezik i tillë është i ulët, dhe 3.3 për qind nuk dëshiruan ta shprehnin mendimin e tyre në lidhje me këtë çështje.

Ndërhyrjet politike nga vendet e tjera në Kosovë janë parë nga të anketuarit gjithashtu si kërcënim potencial për sigurinë e shtetit. Si rrjedhojë, 48.4 për qind e të anketuarve pohuan se ndërhyrjet politike nga vendet e tjera paraqesin rrezik për sigurinë e vendit. Përqindja tjetër prej 26.2 e të anketuarve pohuan se interferencat e tilla përbëjnë vetëm deri diku rrezik, ndërsa përqindja tjetër prej 22.3 nuk shohin ndonjë kërcënim të sigurisë nga ndikimet e huaja politike. Një pjesë tjetër e të anketuarve prej 3.1 për qind nuk e shprehën mendimin e tyre sa i përket kësaj çështje.

Së fundmi, edhe ndërhyrjet kulturore nga jashtë janë çështje të cilat shqetësonin të anketuarit. Rreth 44.3 për qind e të anketuarve konsideruan ndikimet kulturore nga jashtë si rrezik potencial; 23 për qind të tyre i shihnin ndikimet e jashtme kulturore deri diku si kërcënim; ndërsa gati 30 për qind e të anketuarve pohuan se kjo çështje nuk përbën rrezik serioz për sigurinë e shtetit.

## Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia

FIGURA 21: Informimi lidhur me të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për privatësinë



Përkundër progresit të konsiderueshëm nga faza fillestare kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e të dhënave personale, që ka nisur prej vitit 2010 kur u miratua *Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale*, rezultatet e BKS-s e kanë konfirmuar edhe njëherë mungesën e njohurive tek qytetarët lidhur me të drejtat e tyre për privatësi dhe mbrojtje të të dhënave personale. Megjithatë, në krahasim me edicionet e mëparshme të BKS-s, ka një ngritje të vogël sa i përket vetëdijesimit për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat evidentohen në të gjeturat e edicionit aktual të BKS-s. Krahasuar me 70 për qind të të anketuarve, të cilët nuk ishin në dijeni për të drejtat e tyre lidhur me mbrojtjen e të dhënave e që u raportuan në edicionin e mëparshëm, tani, në këtë edicion, janë 63 për qind e të anketuarve që kanë pohuar se janë në dijeni për të drejtat që i gëzojnë kur kemi të bëjmë me mbrojtjen e të dhënave të tyre. Po ashtu, në këtë edicion, 44 për qind e të anketuarve pohuan se nuk janë fare në dijeni lidhur me të drejtat e tyre sa i përket mbrojtjes së të dhënave, e cila megjithatë përbën një përmirësim në krahasim me edicionin e mëparshëm në të cilin 55 për qind u patën shprehur se nuk ishin fare në dijeni për të drejta të tilla. Një pjesë tjetër e të anketuarve prej 19 për qind nuk janë në dijeni, të pasuar nga 14 për qind që janë në dijeni deri diku lidhur me të drejtat në këtë kontekst. Në anën tjetër, 18 për qind e të anketuarve janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, dhe vetëm 4 për qind e të anketuarve theksuan se janë shumë të informuar lidhur me të drejtat e tyre kur bie fjala për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të privatësisë.

Dëshirojmë t'ju shprehim mirënjohje të veçantë të gjithë ata që kontribuan në këtë studim, si dhe për rolin e rëndësishëm në kryerjen e hulumtimeve në terren, mbikëqyrjen dhe monitorimin e përpunimit të të dhënave.

#### Ekipi e kishte këtë përbërje:

Adnan Kryeziu, Agnesa Haxhiu, Agon Ahmeti, Albina Bricori, Andi Emini, Andrra Pllana, Bane Nesovic, Berlinda Krasniqi, Besa Nimani, Dardan Konjufca, Dren Dushi, Edin Jusufi, Egzona Ismajli, Emine Makiqi, Erisa Xhemajli, Gëzim Stavileci, Krenar Vasolli, Krenare Loxha, Kujtim Kryeziu, Lirim Krasniqi, Marigona Dubovci, Mark Marku, Nezir Bytyçi, Përparim Kryeziu, Saranda Pajaziti, Shkëlqim Berisha, Shpresa Kryeziu, Valmira Sokoli, Valton Marku, Vjosa Daku, Yllza Xheladini

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)

Barometri Kosovar i Sigurisë / - Edicioni i katërt . – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2014. - 27 f. : ilustr. me ngjyra; 24 cm.

**ISBN 978-9951-679-12-1**

---

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

ISBN 978-9951-679-12-1



9 789951 679121